



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Prot. 260 Nr.

Durrës, më 14/11/2023

VENDIM

NR 26, datë 14/11/2023

PËR

**"HAPJEN E PROCESIT TË APLIKIMEVE PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË DHËNIES SË GRADËS SHKENCORE "DOKTOR", PRANË FAKULTETIT TË EDUKIMIT, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"**

Në mbështetje të ligjit, Nr. 80/2015, datë 17/09/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", e miratuar me vendim Senati Akademik nr.43, datë 11.02.2020, , të Urdhrit të Rektorit nr. 418 datë 13.11.2023 "Për shpalljen e zgjedhjeve për anëtar të Komisionit të Përherëshëm të Dhënies së Gradës Shkencore "Doktor", pranë Fakultetit të Edukimit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

VENDOSI:

1. Hapjen e procesit të aplikimeve për anëtar të Komisionit të Përherëshëm të dhënies së gradës shkencore "Doktor", pranë Fakultetit të Edukimit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Regjistrimi i kandidatëve, do të zhvillohet nga data 15.11.2023 deri në datën 22.11.2023, orari 08.00 – 16.00, pranë Sekretarisë KZF Edukimit, salla 009, Godina nr.1.
3. Bashkëlidhur vendimit dokumentacioni i cili do të dorëzohet për aplikim.
4. Data e zhvillimit të zgjedhjeve do të jetë data 15.12.2023.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

**KËRKESË PËR KANDIDIM**

**PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS  
SHKENCORE "DOKTOR" NË FAKULTETIN E EDUKIMIT**

Unë i/e nënshkruar/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_, në \_\_\_\_\_, të rrethit \_\_\_\_\_, gjinia \_\_\_\_\_, staf akademik në Departamentin \_\_\_\_\_, Fakulteti \_\_\_\_\_ paraqes kërkesën time për të kandiduar si anëtar i Komisionit të Përherëshëm për Dhënie e Gradës Shkencore "Doktor" në Fakultetin e Edukimit UAMD.

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

- Nuk jam dënuar asnjëherë gjatë jetës time, me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë vepër penale.
- Nuk kam asnjë shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 136/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"
- Nuk kam asnjë shkak për të qenë objekt i ligjit 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentat e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.
- Nuk është caktuar ndaj meje asnjë nga masat e sigurimit personal
- Nuk është dhënë ndaj meje asnjë mase disiplinore e cila është në fuqi

Kësaj kërkesë i bashkangjitet, kopja e kartës së identitetit/pasaportës, kopja e noterizuar e titullit \_\_\_\_\_ që unë zotëroj, vërtetimi i qendrës time të punës, vetëdeklarimi për integritetin e lartë akademik, vetëdeklarimi gjendjes gjyqësore.

Për sa deklarova në këtë kërkesë mbaj përgjegjësi personale dhe autorizoj Komisionin Institucional të Zgjedhjeve të bëjë verifikimet që ai i konsideron të nevojshme.

Aplikuesi

\_\_\_\_\_

U dorëzua sot, më datën \_\_\_\_\_, në zyrën \_\_\_\_\_, tek sekretaria e KZF \_\_\_\_\_, (firma)



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Dokumentacioni për kandidim:

- a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Vetëdeklarim për integritetin e lartë akademik të kandidatit
- c) Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- d) Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- e) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- f) Kopje të noterizuar të titullit akademik, titullit akademik "Profesor" ose "Profesor i asociuar" dhe diplomës/diplomave të arsimit të lartë;
- g) Fotokopje të noteruar të librezës së punës.(Vërtetimi i punës)